



Kuvendi i Komunës në Malishevë
Komisioni Vlerësues
Nr./____
Datë:02.06.2026

PRANUAR MË: 02/06/2026
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO: 01/852
Mr.No. P: _____

Komisioni Vlerësues, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/85, dt.19.03.2026, si dhe duke vepruar sipas dispozitave Ligjore të Ligjit, nr.06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, neni 19, Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, neni 21 par 1, Thirrjes Publike për shprehjen e Interesit sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.02/121, dt.08.03.2024,Thirrja nr.01/765, dt.15.05.2026,

Komisioni Vlerësues me datë 02.06.2026, bënë këtë

NJOFTIM PUBLIK

Komisioni duke vepruar në harmoni me Rregullorën e lartëcekur, si dhe evidentimin e dokumentacionit, ka konstatuar se kemi pasur një (1) ofertë sipas thirrjes publike që mban numrin 01/765, dt.15.05.2026, dhe atë;

-Subjekti Juridik “ Mazreku Farm “ sh.pk me numër unik të biznesi, 812141539

ka ofruar ofertën për marrjen në shfrytëzim të parcelave publike me qëllim të ushtrimit të aktivitetit biznesorë për fermë, për parcelat si në vijim;

1. Parcela me numër të njësisë P-72310015-00249-0, sipas numrit të lëndës 304/24, Zona Kadastrale Guriq, me sipërfaqe prej 53036 m², në vendin e quajtur “ Boka ”, e evidentuar si kullosë e klasës 6, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës;
2. Parcela me numër të njësisë P-72310015-00246-0, me numër të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 59490 m² në vendin e quajtur “ Boka “ e kualitetit jo- pjellores, pronë publike në emër të Komunës së Malishevës;
3. Parcelën me numër P-72310015-0242-0, me numër të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 15803 m², në vendin e quajtur “ Boka “ e kualitetit kullosë e klasit 6, në emër të pronës publike të Komunës së Malishevës;
4. Parcela me numër të njësisë P-72310015-00186-0, me numër të lëndës 304/24, zona kadastrale Guriq, në sipërfaqe prej 1240 m² në vendin e quajtur “Boka “ e kualitetit jo pjellor në pronësi publike të Komunës së Malishevës;
5. Parcela me numër të njësisë P-72310015-00185-0, me numër të lëndës 304/24, Zona Kadastrale Guriq, në sipërfaqe të përgjithshme prej 13924 m², në vendin e quajtur “ Boka “ në pronësi publike në emër të Komunës së Malishevës.

Vlera e ofertës në emër të qiras për një (1) ha është 57 €
Vlera investive 200.000.00 €
Koha e realizimit në tri (3) faza, sipas planit dinamik.

Bazuar në nenin 21 paragrafi 4, të Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. (09/2020) për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, shpallë ofertën e vetme sipas thirrjes publike me numr të përcaktuar si më lartë dhe ofertën e operatorit ekonomik;

-Subjekti Juridik “ Mazreku Farm “ sh.pk me numër unik të biznesi, 812141539

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese, në Komisionin për Ankesa në kuadër të Komunës së Malishevës, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 8 të Rregullorës dhe atë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi publikohet sot, me datë 02.06.2026.

Pas përfundimit të afatit për ankesa, ky Komision do të përgatisë raport me shkrim për punën e tijë, i njëjti do të paraqitet për diskutim dhe votim në Kuvendin e Komunës së Malishevës, të njëjtit do t'i bashkëngjitet edhe kjo ofertë sipas thirrjes publike, pastaj mbetet në autoritetin dhe kompetencën e Kuvendit të Komunës së Malishevës, për procedurë të mëtejme, në lidhje me këtë çështje.

Komisioni vlerësues:

1. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit,
2. Halil Morina-anëtar,
3. Fitim Shala- anëtar,
4. Rifat Mazreku- anëtar,
5. Veton Telaku- anëtar,



Vendi dhe data: Malishevë, më 02.06.2026.